



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 mars 2011
Nr. ref.: RK91/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI. 65/09

Parashtruesja e kërkesës

Zejni Selimi

kërkon

**Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
A. Nr. 727/2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare,

njëzëri miraton këtë Vendim për papranueshmëri të rastit.

HYRJE

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Zejni Selimi, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 727/2009, i 22 tetorit 2009.

Çështja e lëndës

3. Znj. Zejni Selimi, nga Prishtina, ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës më 24 nëntor 2009. Parashtruesja e kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. Nr. 727/2009, të 22 tetorit 2009, që ka të bëjë me të drejtën e saj për pension të aftësisë së kufizuar.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

5. Kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 24 nëntor 2009.
6. Më 17 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarës raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Kadri Kryeziu (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami, anëtare të Kolegjit, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

7. Më 24 nëntor 2009, parashtruesja e kërkesës ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, e cila është regjistruar me nr. KI - 65/09. Megjithëse nuk ka sqaruar konkretisht se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur, mund të konkullohet se parashtruesja e kërkesës e ka kundërshtuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. ref. A. nr. 727/2009, me të cilin refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës që ka të bëjë me të drejtën për pension.
8. Nga shkresat e lëndës mund të konstatohet se në pajtim me Rregulloren Nr. 2003/23, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, më 22 shkurt 2006 nxori një vendim me të cilin parashtrueses së kërkesës i njihet e drejta për pension të aftësisë së kufizuar në mënyrë retroaktive prej 1 janarit 2004, në shumë prej dyzet eurove (40 €). Gjithashtu, në vendim theksohet se tri (3) vjet pas datës së fitimit të kësaj të drejte, parashtruesja e kërkesës do të ftohet nga kjo Ministri për qëllime të rishqyrtimit.
9. Më 2 prill 2009, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke u bazuar në vlerësimin e komisionit mjekësor, i cili ka konkluduar se parashtruesja e kërkesës nuk ka aftësi të plotë, dhe aftësia e kufizuar është e pranishme dhe e përhershme, ka nxjerrë vendim me të cilin e refuzoi kërkesën e znj. Selimi për pension të aftësisë së kufizuar.
10. Më 22 tetor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë aktgjykim me të cilin refuzohet kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës.
11. Në të njëjtin aktgjykim, Gjykata Supreme thekson se komisionet mjekësore, të themeluara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në pajtim me nenin 3.2 të

Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara (LPPAK), në përbërje të mjekëve specialistë të lëmenjve përkatës, pas vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë, kanë gjetur se parashtruesja e kërkesës nuk ka aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme. Prandaj, Gjykata Supreme konstatoi se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e kishte vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe e kishte zbatuar të drejtën materiale kur kishte konstatuar se znj. Selimi nuk i përmbush kriteret e parapara me nenin 3 të LPPAK-së për ta fituar të drejtën në pension për persona me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

12. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë me sa vijon:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

12.1. Nga dokumentacioni i paraqitur mund të konstatohet që parashtruesja e kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

13. Paragrafi 1 i nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese thotë me sa vijon:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht”.

13.1. Vendimi i fundit në lidhje me këtë rast është vendimi i 22 tetorit 2009. Parashtruesja e kërkesës e ka parashtruar kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese më 24 nëntor 2009, që do të thotë se kërkesën e ka paraqitur në këtë Gjykatë në përputhje me afatin e përcaktuar me nenin 49.

14. Megjithëse parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj me qëllim të realizimit të së drejtës së saj të supozuar për pension të aftësisë së kufizuar, ajo nuk ka paraqitur asnjë provë – fakt relevant për të mbështetur pretendimin e saj se “organet administrative apo gjyqësore kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë” (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të rastit Nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

15. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

16. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi ka pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

17. Megjithëkëtë, pas ekzaminimit të dokumenteve të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur asgjë që tregon se procedura para Gjykatës Supreme ka qenë e padrejtë apo e prekur nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*

Kërkesën Nr. 53363/99, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendim i GJEDNJ-së i 31 majit 2005).

PRANDAJ


Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOS

- I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'u dërgohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Dr. Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

